




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KORPORATËS ENERGJETIKE TË KOSOVËS SH.A. PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinion i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinion i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. (KEK sh.a.), të cilat përbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2023, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, prezantonjë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. deri me 31 dhjetor 2023, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2023, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të Kualifikuar

- C1 Menaxhmenti për më shumë së 20 vite nuk kishte kryer rivlerësimet periodike për të gjitha klasat e pasurisë që mbahen në libra sipas modelit të rivlerësimit. Vlera e tyre në fund të periudhës raportuese ishte 9.8 milion euro. Për më tepër, 71.4 % e pasurive të regjistrues janë pasuri në përdorim por të zhvlerësuara tërësisht, pra më vlerë kontabël zero.
- C2 Menaxhmenti, ende nuk ka arritur të përditësoj në tërësi regjistrin e pasurisë për të reflektuar gjendjen faktike për pronat e paluajtshme. Tokë ndërtimore më sipërsa qe prej 1.72 hektar përfshirë lokal me sipërsa qe prej 140m² në qendër të Prishtinës si dhe tokë bujqësore dhe pyjore më sipërsa qe prej 55.7 hektar në Vasilevë, Komuna e Glogocit, janë prona që figurojnë në emër të saj por nuk janë ende të regjistrues janë pasuri të kompanisë ndërsa mban ende në regjistër pesë (5) parcela në Komunën e Podujevës në vlerë prej 7,867,541€ të cilat sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës kishin kaluar në pronësi të Infrakos sh.a., si dhe 11 parcela tjera në vlerë 866,223€, të cilat në bazë të fletave poseduese ishin evidentuar nga komisioni për rivlerësimin e tokave si prona private.

Më gjëresisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standarde Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura përsigurimin e bazës për opinionin.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përvèç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Menaxhmenti përmes procedurës së negocimit kishte nënshkruar kontratë më operatorin ekonomik pa i përbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Vlera e kontratës së nënshkruar ishte 56,522,000€. Poashtu në nëntë (9) raste raste tjera ishin nënshkruar kontratat përmes procedurës së negocimit në vlerë 1,895,203€ pa arsyе bindëse për përdorimin e kësaj procedure.
- A2 Kompania kishte angazhuar një auditor privat, për kundër faktit se kompania ishte subjekt i auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA). Vlera e kontratave të nënshkruara me auditorin privat për dy vite ishte 45,700€.

Më gjërisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standarde Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tonë janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit mbi to

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet në reportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe reportin tonë të auditorit mbi këto pasqyra.

Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale.

Ne kemi marrë parasysh nëse informacionet në reportin për menaxhmentin janë në përputhje me informacionet në pasqyrat financiare dhe deklarata e qeverisjes korporative përfshinë shpalosjet e kërkua me nenet 7 dhe 10 të ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Siç përshkruhet në seksionin e bazës për opinionin e kualifikuar:

- 1 Menaxhmenti, ende nuk ka arritur të përditësoj në tërësi regjistrin e pasurisë për të reflektoar gjendjen faktike për pronat e paluajtshme. Tokë ndërtimore më sipërfaqe prej 1.72 hektar përfshirë lokal me sipërfaqe prej 140m² në qendër të Prishtinës si dhe tokë bujqësore dhe pyjore më sipërfaqe prej 55.7 hektar në Vasilevë, Komuna e Glogocit, janë prona që figurojnë në emër të saj por nuk janë ende të regjistruala në regjistrin e pasurisë të kompanisë ndërsa mban ende në regjistër pesë (5) parcela në Komunën e Podujevës në vlerë prej 7,867,541€ të cilat sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës kishin kaluar në pronësi të Infrakos sh.a., si dhe 11 parcela tjera në vlerë 866,223€, të cilat në bazë të fletave poseduese ishin evidentuar nga komisioni për rivlerësimin e tokave si prona private.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësimë dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësimë dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtoreve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit finansiar të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a..

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërsi nuk përbajnjë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsyе pritet qe të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të KEK sh.a. me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulin, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rr Ethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a..
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Korporatës Energetike të Kosovës sh.a., për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tillë janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçë të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjispcionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Gjetjet që kanë ndikuar opinionin e pasqyrave financiare janë: mos rivlerësimi periodik i pasurive afatgjata që mbahen në libra më vlerë të drejtë dhe mos përditësimi i pronave të paluajtshme më ndryshimet e ndodhura ndër vite.

Të konkluzioni i pajtueshmërisë kanë ndikuar përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe shpërbllimi i operatorit ekonomik me kontratë pa i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Ndërsa gjetjet tjera të cilat nuk kanë ndikuar në opinion por vetëm të menaxhimi financier dhe i pajtueshmërisë janë në brendi të raportit.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjin e nevojshëm të informacionit financier të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrolllet e brendshme lidhur me raportimin financier dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e burimeve të sektorit publik.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime të reja, tre (3) rekomandime pjesërisht të përsëritura dhe një (1) rekomandim i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja C1 - Mos rivlerësimi periodik i pasurive afatgjata që mbahen në regjistër sipas modelit të rivlerësimit

Gjetja	Sipas SNK 16, nëse njësia ekonomike zgjedh modelin e rivlerësimit atëherë, rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt të mjaftueshme që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e pasurive afatgjata (prona, impiantet dhe pajisjet) nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese. Frekuanca e rivlerësimit varet nga ndryshimet në vlerën e drejtë të zërave të pasurive afatgjata (prona, impiantet dhe pajisjet) që rivlerësohen, nëse pasuritë nuk pësojnë ndryshime të rëndësishme dhe të shpeshta në vlerën e drejtë, rivlerësohet zëri vetëm çdo tre ose pesë vjet.
---------------	---

Kompania, kishte në regjistër pasuri që mbahen sipas modelit të rivlerësimit në vlerë neto në libra prej 9.8 milion euro, për të cilat nuk ishin kryer rivlerësimet periodike për më shumë së 20 vite. Kjo vlerë mund të ndryshoj materialisht nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Çështja e rivlerësimit të pasurive ishte rekomandim edhe nga viti i kaluar dhe lidhur më këtë çështje, Menaxhmenti kishte themeluar një komision për rivlerësimin e klasës së tokave-oborre, por jo edhe klasave tjera siç janë objektet, tokat dhe pyjet përmihjet (nxjerrjen e thëngjillit), impiantet, makineritë dhe pajisjet etj. Komisioni ka rivlerësuar tokat bazuar në faturën e tatimin në pronë për vitin 2023 për tokat që gjinden në komunën e Obiliqit ndërsa për tokat në komunat tjera bazuar në Raportin e Vlerësimit të Përgjithshëm të Pronave komerciale, i nxjerrë nga Ministria e Financave (totor 2023). Ky rivlerësim ka rezultuar me rritje të vlerës së tokave për 53.6 milion euro. Pra, vlera e klasës toka - oborre në vitin 2022 ishte 11.4 milion euro ndërsa në vitin 2023 vlera e tokave ishte 65 milion euro.

Për më tepër, 71.4% e gjithsej regjistrat të pasurisë (14,076 prej 19,887 artikujve) me vlerë fillestare 263 milion euro janë pasuri në përdorim por të zhvlerësuara tërësisht, pra më vlerë kontabël zero. Prej tyre 36% kanë të bëjnë me pajisjet e prodhimit të energjisë, thëngjillit, objektet, softuerët dhe tokat përmixt me nxjerrjen e thëngjillit ndërsa 64% kanë të bëjnë me pajisjet dhe inventarin e zyrës. Poashtu 5,663 artikuj kanë vlerë fillestare, vlerë të rivlerësuar dhe vlerë neto në fund zero.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti e kishte konsideruar si industri specifike dhe vështirë të zbatueshëm në praktikë rivlerësimin e të gjitha klasave të pasurisë.

Ndikimi

Mos kryerja e rivlerësimit të pasurive afatgjata në frekuencia të rregullta mund të këtë ndikim material në vlerën e prezantuar të pasurive afatgjata dhe rrjedhimisht edhe në njojen e shpenzimeve të zhvlerësimit për vitin dhe fitimin/humbjen e vitit.

Rekomandimi C1

Bordi i Drejtoreve duhet të sigurojë se do të kryhen rivlerësimet e të gjitha klasave të pasurive që mbahen sipas modelit të rivlerësimit në frekuencia të rregullta të mjaftueshme që të sigurohet se vlera e prezantuar e pasurive në pasqyra financiare nuk ndryshon materialisht nga vlera e tyre e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C2 - Mos përditësimi i regjistrat të pasurisë me ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme

Gjetja

Sipas SNK 16, Toka, ndërtesa, makineria dhe pajisjet janë zëra material që mbahen për përdorim në prodhimin ose furnizimin e të mirave ose shërbimeve, për dhënie me qira palëve të treta ose për qëllime administrative dhe pritet të përdoren gjatë më shumë se një periudhë.

Menaxhmenti edhe përkundër disa veprimeve që kishte marrë gjatë vitit 2023, nuk kishte arritur të përditësoj në tërësi regjistrin e pasurisë për të reflektuar gjendjen faktike për pronat e paluajtshme, si në vijim:

- Sipas certifikatës së pronësisë, kompania ka në pronësi 1.72 hektar tokë ndërtimore në qendër të Prishtinës dhe 140m² lokal. Lidhur me këtë çështje, gjatë vitit 2023 kompania kishte arritur të regjistroj 10.6 ari tokë që ndërlidhën me parcelën e lartcekur (15.9 ari janë të raportuara në regjistrin e pasurisë në fund të vitit 2023 ndërsa 5.33 ari ishin në fund të vitit 2022) ndërsa për pjesën tjeter të parcelës dhe lokalin kompania është ende në proces të trajtimit të kësaj çështje.
- Kompania mban ende në regjistër pesë (5) toka me vlerë neto në libra prej 7,867,541€, të cilat ishin bartur ndërmarrjes publike Infrakos sh. a., sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës të vitit 2010 përkatësisht Marrëveshjes për transferimin e pasurive mes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Infrakos sh. a. të vitit 2012.
- Kompania sipas aktvendimeve të shpronësimave është pronare e 116.88 hektar në zonën kadastrale Vasilevë, Komuna e Glogocit. Prej tyre, kompania gjatë vitit 2023, kishte regjistruar parcelat në sipërfaqe 61.1 hektar, ndërsa për pjesën tjeter, është në proces gjyqësor.
- Komisioni për rivlerësimin e tokave, ka evidentuar se në regjistër të pasurisë ekzistojnë 11 toka, më vlerë kontabël në libra prej 866,223€ të cilat në bazë të fletave poseduese janë prona private. Lidhur me këtë, menaxhmenti kishte kërkuar nga komunat përkatëse që të analizohet historiati i këtyre parcelave dhe pastaj pritet të ndërmerrën veprimet konkrete.

Mos prezantimi i plotë dhe i saktë i pronave të paluajtshme kishte ndodhur për shkak të kompleksitetit të çështjeve pronësore që ndërlidhen më palët e treta si dhe mungesës së veprimeve efektive të ndërmarra nga kompania ndër vite.

Ndikimi

Mos përditësimi i regjistrat të pasurisë me gjendjen aktuale të pronave të paluajtshme ndikon në nënvlërësimin përkatësisht mbivlerësimin e vlerës së pasurisë afatgjatë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi C2

Bordi i Drejtoreve duhet të sigurojë së janë marr veprimet e nevojshme për trajtimin e të gjitha çështjeve pronësore të kompanisë dhe të përditësoj regjistrin e pasurisë me gjendjen aktuale duke prezantuar saktë dhe të drejtë pasurinë afatgjatë të kompanisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi tek procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë

Gjetja

Neni 35 i Ligjit për prokurimit publik, thekson se autoriteti kontraktues mund të përdor procedura të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës nëse për arsyet objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, për arsyet të mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale apo industriale apo të drejtave ekskluzive dhe për arsyet të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsyet nga autoriteti kontraktues.

Sipas rregullores së prokurimit publik nr. 001/2022, nen 17 pika 7, përcakton se Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Pjesa C përbëhet nga Formulari i tenderit dhe Lista e çmimeve. Poashtu në dosjen e tenderit, tek kërkesat e përshtatshmërisë, pika h, përcakton se operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi që aktualisht nuk është me vonesë në pagesën e ndonjë kontributi të sigurimeve shoqërore ose tatimore në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përvèç rasteve kur ky borxh konsiderohet të jetë i parëndësishëm në Kosovë. Periudha kohore në rast të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës, kalkulohet nga data kur ftesa për pjesëmarrje i është dërguar operatorit ekonomik.

Menaxhmenti, gjatë vitit 2023, kishte nënshkruar gjithsej 40 kontrata në vlerë totale 70,012,969€ duke përdorur procedurën e negocimit pa publikim të njoftimit për konratë. Prej tyre ne kemi testuar 12 aktivitetetë të prokurimit sipas kësaj procedure dhe kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- në dosjen e tenderit "Modernizimi i Turbinave B1 dhe B2", tek Pjesa C, Menaxhmenti kishte kërkuar që operatori ekonomik të ofroj çmimin për njësi për secilin pozicion në paramasë ndërsa oferta e dorëzuar nga operatori ekonomik nuk ishte plotësuar paramasen sipas kërkesave të dosjes së tenderit (listen e çmimeve) por ishte plotësuar vetëm në totale për komponentë. Po ashtu vërtetimi tatimor i dorëzuar nga operatori ekonomik nuk ishte valid. Menaxhmenti i kishte dërguar operatorit ekonomik ftesën për pjesëmarje në tender me datën 09 dhjetor 2022, operatori ekonomik e kishte dorëzuar vërtetimin tatimor të datës 05 tetor 2022 ndërsa kontrata ishte nënshkruar me 24 shkurt 2023 në vlerë 56,522,000€. Menaxhmenti nuk e kishte kërkuar edhe njëherë vërtetimin tatimor për të ri konfirmuar gjendjen e obligimeve tatimore të operatorit ekonomik para nënshkrimit të kontratës.
- nëntë (9) raste, në vlerë 1,895,203€, ishin nënshkruar kontratat përmes procedurës së negocimit për shkak të situatave emergjente në të cilat tashmë gjendej kompania. Këto kontrata kishin të bëjnë më shërbime dhe furnizime të ndryshme si: Ruajtja dhe sigurimi i objekteve të kompanisë, sigurimi shëndetësor për punonjësit e kompanisë, transporti i punonjësve të kompanisë, furnizimi me mazut, furnizim me acid klorhidrik, konsulencë ligjore, shërbime për zhvendosjen fizike dhe ekonomike për një pjesë të fshatrave të Komunës së Obiliqit. Arsyet e ofruara nga kompania nuk ishin bindëse dhe nuk kishin të bëjne më situata ektreme emergjente që nuk mund të parashikoheshin. Për më shumë i atribuohen mos planifikimit të duhur dhe neglizhencës ashtu siç kishte dhënë opinion Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), në tre prej këtyre raste.

Komisioni vlerësues gjatë negociatave me operatorin ekonomik kishte kërkuar që çmimet të jenë për njësi për secilin pozicion në paramasë por operatori ekonomik kishte deklaruar se nuk ka mundësi ta ofrohen çmimet në formatin e paraqitur në formularin e dosjes së tenderit. Sa i përket vërtetimit tatimor jo valid komisioni vlerësues e kishte konsideruar ende të vlefshëm vërtetimin më vjetër se 90 ditë për shkak të përdorimit të procedurës së negociuar.

Nënshkrimi i kontratave të lartcekura përmes procedurës së negociuar kishte ndodhur si rrjedhojë e mangësive në procesin e planifikimit të aktiviteteve të prokurimit.

Ndikimi

Kontratat me negocim pa publikim të njoftimit për konratë ndikojnë në minimizimin e konkurrencës dhe pamundësojnë transparencën dhe trajtimin e barabartë për të gjitha palët e interesuara ndërsa mos plotësimi i formularit të çmimeve për njësi nga operatori ekonomik ndikon në mungesë transparence për çmimin e ofruar dhe vështirësi në pranimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve gjatë implementimit të kontratës. Poashtu vërtetimi tatimor jo valid nuk konfirmon pranueshmërinë e operatorit ekonomik lidhur me gjendjen e obligimeve tatimore.

Rekomandimi A1

Bordi i Drejtoreve duhet të forcoj procesin e planifikimit të aktiviteteve të prokurimit në mënyrë që të shhang makismalisht përdorimin e procedurave me negocim pa publikim të njoftimit më kontratë. Poashtu Bordi i Drejtoreve duhet të siguroj që nënshkrimi i kontratave me operatorët ekonomik bëhet vetëm pasi që të përmushen të gjitha kushtet e dosjes së tenderit, në këtë rast formulari i përshkrimit të çmimit dhe vërtetimi lidhur më gjendjen e obligimeve tativore duhet të jetë në harmoni me kërkesat e ligjit të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjërësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Nënshkrimi i kontratës për auditimin e Pasqyrave Financiare

Gjetja

Sipas nenit 137 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës neni 137 pika 3 Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës kontrollon veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjera, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti.

Ndërsa sipas nenit 33.3 të Ligjit nr. 03/I-087 për Ndërmarrjet Publike (i ndryshuar dhe i plotësuar), Auditimin e Pasqyrave Financiare do ta bëjë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në të kundërtën, Zyratari i Prokurimit i NP-së do të prokurojë shërbimet e një auditori për kryerjen e auditimit të jashtëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik dhe me nenin 33 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Kontrata përkatëse do të ketë kohëzgjatje prej tri (3) viteve.

Po ashtu sipas Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 18, pika 4, citon: Zyra Kombëtare e Auditimit mund të kryej auditime të detyrueshme të rregullsisë në Ndërmarrjet Publike. Auditori i Përgjithshëm informon Aksionarin më së voni me 30 shtator të vitit aktual mbi atë se cilat nga këto auditime do të kryhen.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) e kishte njofuar me kohë kompaninë se do të jetë subjekt i auditimit nga ZKA për auditimin e pasqyrave financiare sipas kërkesave të SNRF-ve për vitin 2022 përkatësisht 2023.

Pavarësisht kësaj, kompania më datat 13 dhjetor 2022 dhe 17 nëntor 2023 kishte lidhur kontrata për shërbime të auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2022 në vlerë 21,800€ dhe vitin 2023 në vlerë 23,900€, për raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore sipas kërkesave të SNRF-ve dhe raporte të auditimit sipas kërkesave nga udhëzimet rregullative të kontabilitetit të Zyrës së Rregulatorit të Energjisë (ZRRE) dhe Komisionit të Pavarur për Mininera dhe Minerale (KPMM). Dy raportet e fundit janë obligim i kompanisë ndaj ZRRE-së dhe KPMM-së.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Menaxhmenti nuk kishte trajtuar mirë kërkesat ligjore.

- Ndikimi** Angazhimi i shërbimeve të auditimit edhe nga auditori privat, për kundër faktit se ishte subjekt i auditimit nga ZKA, përvèç që do të shkaktoj shpenzime shtesë ndërmarrjes, mund të krijoj paqartësi tek lexuesit e pasqyrave financiare dhe vet kompaninë.
- Rekomandimi A2** Bordi i Drejtoreve duhet të siguroj që në rastin e angazhimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për shërbime të auditimit të PFV, të mos bëhen shpenzimet të pa nevojshme për auditim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjërësisht shih Shtojcën I

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit finansiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative janë realizuar në 82,904,000€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet të mirëmbajtjes, tarifat e licencës, shpenzimet e trajnimit dhe udhëtimit, shpenzimet e zyrës dhe ato administrative, shpenzimet e mjeteve motorike, shpenzimet për konsulencë, dhe të tjera.

Çështja A3 - Shkurtimi i afatit kohor për pranimin e tenderëve

Gjetja Ligji i prokurimit publik, neni 44, ndër të tjera thekson se autoritetet kontraktuese nuk lejohen të përcaktojnë afate kohore të cilat janë më të shkura se ato të caktuara me Ligj (afatet kohore minimale). Për procedurat e hapura me vlera të mëdha afati kohor për pranimin e tenderëve është 40 ditë.

Kompania në aktivitetin e prokurimit “Shamotimi, Izolimi tek Kanalet Ri qarkulluese dhe Pllakat Rrëshqitëse në TC Kosova B” më vlerë të parashikuar të kontratës prej 808,606€ kishte shkurtuar afatin për pjesëmarrjen në tender nga 40 ditë sa kërkohet në vetëm 17 ditë. Kompania e kishte shkurtuar afatin kohor nën arsyetimin që të përshtatë kohën e realizmit të projektit gjatë periudhës sa ky bllok pritej të jetë jashtë funksionit për shkak të një remonti të paraparë nga një projekt tjetër.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos planifikimit më të mirë të orarit të projekteve që pritej të ndërmerren në TC Kosova B.

Ndikimi Shkurtimi i afateve pa arsyetime bindëse dhe të bazuara ligjore, mund të kufizojë konkurrencën dhe përrnjohet që mos marrjen e ofertave më të përshtatshme për kompaninë.

Rekomandimi A3 Bordi i Drejtoreve duhet të siguroj që planifikimi projektet investive të jetë i bashkërenduar në mënyrë që afatet kohore të përcaktuara më Ligjin e prokurimit publik të respektohen në tërsi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Mangësi në planet e menaxhimit të kontratës

Gjetja Rregullat dhe udhëzuesi për prokurimin publik, neni 70, ndër të tjera kërkon që të gjithë menaxherët e kontratave si nga ana e autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik duhet të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me manualet për përdorim të modulit për menaxhim të kontratës. Tute kërkohet që të bëhet vlerësimi i performancës së kontraktuesve gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave kornizë.

Nga 20 procedurat të prokurimit të audituara, ne kemi vërejtur se kompania në:

- në 19 raste plani për menaxhimin e kontratës nuk ishte nënshkruar nga Menaxheri i kontratës së kompanisë dhe operatorit ekonomik. Këto plane ishin të aprovuar dhe zhvilluar vetëm në formatin elektronik e - prokurim.
- në 10 raste tjera planet për menaxhimin e kontratave vetëm ishin postuar në formatin elektronik e-prokurim por nuk ishin përditësuar më tutje bazuar në punët e kryera.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit efektiv të kontrollit të brendshëm për menaxhimin e kontratave të nënshkruara.

Ndikimi	Mos nënshkrimi i planeve për menaxhimin e kontratës si dhe mos shfrytëzimi modulit për menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e performancës përmes sistemit e-prokurimi ndikon që kontratat të mos mbikëqyrin në kohë reale dhe potencialisht rrithë rrezikun që shërbimet apo furnizimet të mos ofrohen në kohë ashtu siç është nënshkruar kontrata.
Rekomandimi A4	Bordi i Drejtoreve duhet të siguroje se janë eliminuar të gjitha pengesat të cilat kanë ndikuar në mos zbatimin e kërkesave ligjore si dhe të sigurojë menjëherë fillimin e përdorimit të moduleve të E-prokurimit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performances së kontraktueseve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Përdorimi i shpeshtë i procedurës me vlerë minimale

Gjetja	Sipas nenit 16,17 dhe 18 të Ligjit për prokurimin publik ndër të tjera thekson se Autoriteti Kontraktues nuk do të zgjedhë ose përdorë metoda të vlerësimit, që kanë për qëllimi zvogëlimin e vlerës së kontratës për furnizime/shërbime/pune nën kufirin e përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji; dhe asnjë autoritet kontraktues, nuk do të ndaje kërkesën për prokurimi për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim/shërbime/punë nën kufirin e përcaktuar në nenit 19 të këtij ligji.
---------------	---

Kompania kishte zhvilluar gjithsej 163 aktivitete të prokurimit me vlerë minimale gjatë vitit 2023, kjo paraqet 33% të numrit të aktiviteteve të zhvilluara të prokurimit.

Këto prokurime kanë të bëjnë me:

- 12 kontrata për ujë të pijes dhe pije për bufe, në vlerë 8,834€;
- 10 kontrata për furnizim me tonerë, në vlerë 6,681€;
- 8 kontrata për bateri të automjeteve, në vlerë 5,702€;
- 7 kontrata për furnizim me kushineta, në vlerë 4,717€ euro;
- 5 kontrata për furnizim me maska mbrojtëse, në vlerë 4,295€;
- 3 kontrata për furnizim me material higjenik, në vlerë 2,805€;
- 3 kontrata për Servisimi, bazhdarimi, kalibrimi dhe certifikimi i peshores, në vlerë 2,854€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos planifikimit të duhur të nevojave nga njësítë kërkuese, edhe përkundër zotimit të menaxhmentit në plan të veprimit që ky rekomandim është zbatuar.

Ndikimi	Ndarja e tenderëve në vlera të vogla dhe minimale ndikon në efikasitetin e zyrës së prokurimit, ngarkohet me numër me të madhe të aktiviteteve. Gjithashtu ndarja mund të ndikojë në ekonomicitetin e aktivitetit të prokurimit, çmimet e ofertave për sasi më të vogla mund të jenë me të larta se çmimet e ofertave për sasinë me të madhe.
Rekomandimi B1	Bordi i Drejtoreve duhet të siguroj se kërkesat nga njësit kërkuese të grupohen në mënyrë që të zhvillohen me pak aktivitete të prokurimit që sigurojnë konkurrencë më të lartë dhe çmime më ekonomike. Për të shmangur përsëritjen e aktiviteteve të prokurimit, kompania duhet t'i grumbullojë nevojat në mënyrë që të jetë me efikas dhe më ekonomik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Sistemet Informativë

Në këtë fushë është përfshirë vetëm përcjellja e zbatimit të rekomandimeve për pjesën e TI-së në KEK Sh.A.

Çështja C3 - Kriptimi i laptopëve dhe qasja e përdoruesve përmes rrjetit privat virtual

Gjetja Sipas Politikës së sigurisë së Informacionit, Laptop-i duhet të përmbajë një skedar të enkriptuar ose kontejner (folder) disku dhe i gjithë informacioni në lidhje me punën do të ruhet në ata kontejnerë të skedarëve të koduar. Po ashtu, para se t'u lejohet qasja të punësuarve në VPN në rrjetin e kompanisë, atyre u kërkohet të plotësojnë formular të veçantë për aplikim për qasje në rrjetin virtual privat - VPN.

Në 21 raste të testuara kemi identifikuar që skedarët e veçantë të enkriptuar ishin krijuar ashtu siç udhëzon politika e sigurisë së informacionit mirëpo këta skedarë nuk ishin përdorur plotësisht nga shfrytëzuesit. Po ashtu, shfrytëzuesit nuk kanë plotësuar formularin e veçantë për qasje përmes rrjetit privat virtual (VPN) siç kërkohet me politikën e sigurisë së informacionit për qasje në VPN. Shfrytëzuesit i kishin bërë kérkesat përmes e-mail, me shpjegimin e arsyes për qasje në VPN.

Kjo kishte ndodhur, për shkak se Politika e Sigurisë së Informacionit ishte aprovuar në gjysmën e dytë të vitit dhe ende nuk kishte pasur mbikëqyrje strikte të zbatimit.

Ndikimi Mos zbatimi i plotë i këtij rekomandimi për pajisje mobile - laptopët, rrezikon humbjen dhe shpërndarjen e të dhënave të ndjeshme, konfidenciale të kompanisë, gjë e cila do të mund të dëmtoj imazhin dhe të shkaktoj edhe humbje financiare në kompani. Mungesa e zbatimit të politikës së sigurisë, për plotësimin e një formulari për qasje nga distanca përmes VPN, e bën monitorimin e sigurisë më të cenueshëm ndaj rrezikut për qasje të paautorizuar.

Rekomandimi C3 Bordi i Drejtoreve duhet të sigurojë se të gjithë punonjësit e kompanisë të zbatojnë politikën e sigurisë së informacionit në kompani dhe të vendosin të gjitha të dhënat e tyre të ndjeshme në skedarin e enkriptuar. Poashtu, duhet të zbatohet politika e sigurisë së informacionit për qasjen përmes VPN. Të rishikohen qasjet e vjetra dhe për aprovimet e reja të plotësohen formularët për lejimin e qasjes përmes VPN.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i Auditimit për vitin 2022 kishte rezultuar me 15 rekomandime. Kompania kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, 12 rekomandime ishin zbatuar, dy (2) rekomandime ishin pjesërisht të zbatuar dhe një (1) ende i pa zbatuar. Poashtu në tabelën e rekomandimeve janë edhe 17 rekomandime të dhëna në Letër Menaxhment nga auditori privat për PFV 2021. Prej tyre, katër (4) rekomandime ishin zbatuar, një (1) ishte zbatuar pjesërisht dhe 12 nuk janë të aplikueshme më.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën në vijim.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarrë	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtoreve të sigurojë se do të kryhen rivlerësimet e pasurive në frekuenca të rregullta të mjaftueshme që të sigurohet se vlera e prezantuar e pasurive në pasqyra financiare nuk ndryshon materialisht nga vlera e tyre e drejtë në fund të periudhës raportuese.	Menaxhmenti, gjatë vitit 2023, ka rivlerësuar klasën e pasurisë - tokat oborr, por jo edhe klasat tjera të pasurisë që mbahen sipas modelit të rivlerësimit si: tokat dhe pyjet për nxjerrjen e thëngjillit, objektet, impiantet, makineritë dhe pajisjet e prodhimit etj.	Pjesërisht i zbatuar

2.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë së janë marr veprimet e nevojshme për trajtimin e çështjeve pronësore të kompanisë dhe të përditësoj regjistrin e pasurisë me gjendjen aktuale duke prezantuar saktë dhe të drejtë pasurinë afatgjatë të kompanisë.	Menxhamenti nuk kishte përditësuar në tërësi regjistrin e pasurisë për të reflektuar gjendjen aktuale të pronave të paluajtshme.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, së bëhen vlerësimet e nevojshme për kontingjencat dhe të jepen informacionet shpjeguese të plota në pasqyra financiare.	Nuk kemi identifikuar raste të nevojshme për shpalosje si kontingjenca gjatë vitit 2023.	I zbatuar
4.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë njohjen e llogarive të arkëtueshme përkatësisht të hyrave nga interesit në periudhën e duhur kontabël në mënyrë që pasqyrat financiare të përbajnjë vetëm transaksionet dhe ngjarjet që i përkasin vitit.	Menaxhmenti ka ndërmarr veprimet e nevojshme korrigjuese në lidhje me njohjen e të hyrave nga interesit në periudhat e duhura kontabël.	I zbatuar
5.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin periodik të gjendjes mes kompanisë dhe furnitorëve në mënyrë që të këtë pasqyrë sa më të qartë përdetyrimet e saj ndaj furnitorëve.	Nga mostrat e testuara nuk kemi identifikuar mos përputhje të gjendjes së obligimeve ndaj furnitorëve.	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të siguroj që të bëhet rishikimi i politikës së provisionimit të stoqeve në mënyrë që provisionimi të bëhet sipas grupeve të artikujve të lidhur ose me karakteristika të ngjashme ashtu siç kërkohet me SNK 2.	Menaxhmenti ka rishikuar procedurën e provisionimit të stoqeve gjatë vitit 2023.	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që kompania me rastin e furnizimeve të përdor procedura të hapura të prokurimit si dhe indeksimin e çmimeve sipas berzës kur kjo është e mundur.	Nga mostrat e testuara nuk kemi identifikuar raste të shmangjës së çmimeve të bërzës kur kjo është e mundur.	I zbatuar
8.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj së vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përbajtjesore të kontratës publike të bëhen me kohë si dhe nënshkrimi i kontratave të bëhet para fillimit të ekzekutimit të punëve përkatësisht marrjes së shërbimeve.	Nga mostrat e testuara nuk kemi identifikuar në raste të kryerjeve të punëve pa kontratë valide.	I zbatuar

9.	Kontrollet e brendshme në raportimin financier	Ne rekmandojmë që Kompania: të përcaktojë dhe definojë të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit në softuerin e ri; të vazhdojë me kujdes të shtuar fazën e futjes në përdorim dhe t'i shfrytëzojë të gjitha funksionet e tij; të ofojë trajnimet e duhura stafit në përdorim dhe shfrytëzim të softuerit; të gjej mënyrën më të mirë të mirëmbajtjes dhe zhvillimit të mëtutjeshëm.	Rekomandimi nga Letër Menaxhmenti i vitit 2021.	Nuk është i aplikueshëm më
10.	Kontrollet e brendshme në raportimin financier	Ne rekmandojmë Kompaninë që të shtohen kontrollat monitoruese aty ku mundësia e gabimit është më e madhe.	Rekomandimi nga Letër Menaxhmenti 2021.	Nuk është i aplikueshëm më
11.	Kontrollet e brendshme në raportimin financier	Ne rekandojmë Kompaninë që të shikojë mundësitet e avancimit të softuerit i cili përdoret aktualisht, apo të pajiset me ndonjë softuer të ri i cili do t'i plotësojë të gjitha kërkasat si pjesën financiare ashtu edhe menaxheriale.	Rekomandimi nga Letër Menaxhmenti 2021.	Nuk është i aplikueshëm më
12.	Kontrollet e brendshme në raportimin financier	Ne rekandojmë Kompaninë që raportet e tillë të jenë të finalizuara në momentin kur ato dërgohen tek Bordi i Drejtoreve për aprovim.	Rekomandimi nga Letër Menaxhmenti 2021.	Nuk është i aplikueshëm më
13.	Kontrollet e brendshme në raportimin financier	Bordi i Drejtoreve duhet të sigurojë se pasqyrat financiare janë përgatitur, aprovuar dhe publikuar në afatet e përcaktuara ligjore.	Menaxhmenti ka përgatitur pasqyrat financiare dhe raportin vjetor brenda afatit të kërkuar më Ligjin për ndërmarrjet publike	I zbatuar
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Ne rekandojmë që Kompania të shmang në maksimum vonesat në kryerjen e investimeve kapitale sipas afateve të kontraktuara.	Rekomandimi nga Letër Menaxhmenti i vitit 2021.	Nuk është i aplikueshëm më
15.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i Drejtoreve duhet të sigurojë procedura të harmonizimit periodik të llogarive me debitorët dhe gjithashtu të rishqyrtoj regjistrin llogarive të arkëtueshmeve në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë sa më saktë dhe drejt gjendjen e kompanisë.	Menaxhmenti ka ndërmarrë veprimet e nevojshme lidhur më borxhet e vjetra dhe harmonizimet më klientët.	I zbatuar
16.	Stoqet	Ne rekandojmë që Kompania të bëjë rishikimin e procedurës së provizionimit të stoqeve në mënyrë që provizionimi të përcaktohet në bazë të disa parametrave specifik të stoqeve, si lëvizshmëria, afati i përdorimit, gjendja fizike etj. Ne rekandojmë që për stoqet e vjetra dhe të dëmtuara për të cilat nuk pritet që të përdoren në periudhat e ardhshme të përcaktohet trajtimi i tyre i mëtjeshëm.	Rekomandimi nga Letër Menaxhmenti i vitit 2021.	Nuk është i aplikueshëm më

17.	Stoqet	Ne rekomandojmë Kompaninë që të rishikojë mënyrën e menaxhimit të inventarit, duke filluar nga rishikimi i procedurave dhe proceseve të brendshme si dhe të bëhet avancimi i modulit të inventarit. Artikujt e identifikuar si të vjetëruara apo të ngadalëtë duhet të ndahen. Kjo do të ndihmojë në uljen e niveleve të inventarit dhe do të përmirësojë gjendjen e depos. Ajo gjithashtu mund të rrisë produktivitetin e personelit të depos dhe të eliminojë mallin me afat të skaduar. Prandaj, inventari duhet të analizohet tërësisht, duke vlerësuar çdo arikull kundër përdorimit të pritshëm në të ardhmen.	Rekomandim nga Letër Menaxhmenti i vitit 2021.	Nuk është i aplikueshëm më
18.	Stoqet	Ne rekomandojmë që Kompania të fillojë një proces të unifikimit të nomenklaturave për të gjitha njësitë e saj në listat e stoqeve në mënyrë që jetë një sistem unik dhe të mundësojë identifikimin e lehtë të arikuve gjatë përdorimit apo numërimit të tyre. Po ashtu, ne rekomandojmë që depotë dhe ambientet të rregullohen në mënyrë që t'i mberojnë artikujt e stokut nga dëmtimet e ndryshme atmosferike, po ashtu artikujt të sistemohen nëpër rende dhe rafte të rregullta, në mënyrë që të identifikohen lehtësisht dhe të mundësojnë numërimin sa më të saktë.	Rekomandim nga Letër Menaxhmenti i vitit 2021.	Nuk është i aplikueshëm më
19.	Pasuritë afatgjata	Ne rekomandojmë Kompaninë që përveç azhurnimit të regjistrat të saj të aseteve, të iniciojë dhe të zgjidh këtë çështje me autoritetet përkatëse sa më parë.	Kompania kishte themeluar një grup punues për evidentimin dhe sqarimin e pronësisë se pronave të paluajtshme. mirëpo përditësimet me gjetjet e grupit punues ende nuk ishin reflektaar në regjistër të pasurisë.	Nuk është i aplikueshëm më
20.	Të hyrat	Ne rekomandojmë që procedurat të dokumentohen dhe të pëcaktohen në një manual që gjithashtu duhet të tregojë caktimin e detyrave për departamentet ose punonjësit individualë të cilët merren me eksport të energjisë. Poashtu ne rekomandojmë Kompaninë që të gjitha departamentet dhe funksionet e Kompanisë të kenë procedurat dhe manualet e punës si dhe të bëhet azhurnimi në baza të rregullta kohore së paku një herë në vit.	Rekomandim nga Letër Menaxhmenti 2021.	Nuk është i aplikueshëm më

21.	Të hyrat	Bordi i Drejtoreve duhet të sigurojë se janë hartuar dhe aprovuar të gjitha rregulloret dhe procedurat e nevojshme për funksionimin e kompanisë, si dhe të bëhet azhurnimi i tyre bazuar në nevojat e kompanisë.	Kompania me datë 27.06.2023 kishte aprovuar rreguloren për miratimin e procedurës për tregtimin dhe shkëmbimin e elektrike, dhe kjo rregullore ishte duke u aplikuar.	I zbatuar
22.	Të hyrat	Bordi i Drejtoreve duhet të sigurojë procedura të brendshme efektive për të arritur rezultatin maksimal të kompanisë dhe eliminimin e kostove më të larta në të ardhmen.	Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur raste të përsëritjes së ankandeve.	I zbatuar
23.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtoreve të siguroj së kërkesat nga njësitë kërkuese grupohen në mënyrë që të zhvillojë më pak aktivitete të prokurimit që sigurojnë konkurrencë me të lartë dhe çmime më ekonomike.	Edhe këtë vit kompania ka pasur numër të madh të kontratave më vlerë minimale.	Nuk ka filluar zbatimi
24.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtoreve duhet të siguroj së nuk vendosen kërkesa e panevojshme në dosje të tenderit në mënyrë që të u jepet mundësi të gjithë operatorëve ekonomik të marrin pjesë në tender dhe të arrihen çmime ekonomike.	Nga mostrat e testuara nuk kemi identifikuar kërkesa të panevojshme në dosje të tenderit të cilat kufizojnë konkurrencën.	I zbatuar
25.	Shpenzimet e pagave	Kompania duhet të respektojë në plotëni ligjet, politikat, procedurat e brendshme si dhe vendimet tjera për personelin që aprovoohen nga Bordi Drejtues i Kompanisë. Ne rekmandojmë që të bëhet rishikimi i dosjeve të punëtorëve dhe të bëhet plotësimi i tyre.	Rekomandim nga Letër Menaxhmenti i vitit 2021.	Nuk është i aplikueshëm më
26.	Shpenzimet e pagave	Ne rekandojmë Kompaninë që të gjitha departamentet dhe funksionet e biznesit të kenë procedurat dhe manualet e punës si dhe të bëhet azhurnimi në baza të rregullta kohore së paku një herë në vit.	Rekomandim nga Letër Menaxhmenti i vitit 2021.	Nuk është i aplikueshëm më
27.	Shpenzimet e pagave	Bordi i Drejtoreve të siguroj që të bëjë azhurnimin me kohë të vendimeve që lidhen me kompensimet e punëtorëve si dhe të siguroj që do të merren veprimet e nevojshme për azhurnimin e kontratave të punës ashtu që dispozitat e kontratave të mos jenë në kundërshtim me ligjin.	Menaxhmenti ka ndërmarrë veprimet e nevojshme duke azhurnuar dhe plotësuar kontratat e punonjësve dhe vendimet mbi përfitimet e punonjësve.	I zbatuar

28.	Sistemet Informativë	Ne rekomandojmë që të kriptoni të gjitha disqet e pajisjeve në pronësi të korporatës, veçanërisht ato që përdoren jashtë rrjetit të KEK-ut.	Departamenti i TI-së kishte krijuar skedarët e enkriptuar mirëpo këta skedar nuk gjatë vitit 2023 nuk ishin përdor nga shfrytëzuesit. Të kërkuesat për qassje në VPN ishin bërë përmes emailit dhe jo formularit standard siç e kërkon politika.	Pjesërisht i zbatuar
29.	Sistemet Informativë	Ne rekomandojmë që të kërkoni raporte të rregullta me shkrim nga stafi i TIK në lidhje me testet e rikthimit të të dhënave dhe sistemeve kritike të korporatës.	Menaxhmenti ka ndërmarrë veprimet e nevojshme lidhur me testet e rikthimit të të dhënave dhe sistemeve kritike të korporatës. Gjatë auditimit kemi marrë 3 raportet e fundit me shkrim nga stafi i TIK për testet e realizuara të rikthimit të të dhënave dhe sistemeve kritike të korporatës.	I zbatuar

30.	Sistemet Informatice	Ne rekomandojmë që të specifikoni qartë periudhat kohore për çdo procedurë dhe rishikoni nëse ekziston nevoja për të përgatitur dokumente të tjera mbështetëse siç janë: Udhëzimet për reagim në raste të emergjencave, Plani i Vazhdimësisë së Biznesit, Plani i Rimëkëmbjes në rast të katastrofës, procedurat shtesë për testet e rikthimit etj.	Politika e Teknologjisë Informatice është miratuar në qershor 2023. Në politikën e miratuar dhe në shtojcat e tjera të hartuara nga Divizioni i TI-së së KEK SH.A., janë specifikuar qartë periudhat kohore për ruajtjen e të dhënave për se cilën procedurë, duke përfshirë arkivimin dhe testimini. Si dhe kanë hartuar dokumente tjera ndihmëse si lloj udhëzuesish për reagimin në rast emergjencave, vazhdimësinë e biznesit dhe rimëkëmbjen në rast të katastrofës natyrore.	I zbatuar
31.	Sistemet Informatice	Ne rekomandojmë menaxhmentin e TIK për të rishikuar nëse kjo praktikë duhet të lejohet. Kufizimi i qasjes. Proxy i brendshëm dhe filtrimi i përbajtjes janë masa të rëndësishme të sigurisë për të minimizuar ekspozimin ndaj sulmeve që vjen nga rrjeti i brendshëm i korporates.	Gjatë auditimit ne kemi identifikuar se në konfigurimin e rrjetit të kompanisë janë të zbatuara rregullat e listave të kontrollit të qasjes (Access List Policy Rules) dhe kufizimi përmes Proxy firewall.	I zbatuar

32.	Sistemet Informatike	<p>Ne rekomandojmë kontraktimin e një kompanie të specializuar në sigurinë e TIK për të testuar rrjetet dhe sistemet e TIK të KEK për ndonjë cenueshmëri. Nëse ka ndonjë të tillë, kërkonit rekomandime profesionale se si t'i përmirësoni ose rregulloni ato.</p>	<p>Divizioni i TI-së si njësi kërkuese gjatë vitit 2022 ka iniciuar kërkesën për zhvillimin e procedurës tenderuese për ofrimin e shërbimeve - testim të infrastrukturës “Penetration Testing”, mirëpo nuk ka rezultuar me sukses zhvillimi i procedurës. Gjithashtu ky divizion ka aplikuar konfigurimet e nevojshme për të ngritur nivelin e sigurisë së informacionit në kompani dhe ka monitoruar në vazhdimësi kërcënimet përsulme të mundshme të cilat kanë qenë të menaxhuara dhe pa ndonjë incident të sigurisë.</p>	I zbatuar
-----	----------------------	--	--	-----------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit

Naim Neziri, Udhëheqës i ekipeve

Xhevrat Hasolli, Anëtar i ekipeve

Arbresha Grainca, Anëtare e ekipeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Shkurtimi i afatit kohor për pranimin e tenderëve	Zyra e Prokurimit bën përpjekje te vazhdueshme qe te respektoj afatet kohore për shpalljen e tenderëve sipas Ligjit te prokurimit dhe rregullores dhe udhëzuesit te prokurimit publik. Ne rastin konkret zyra e prokurimit ka përdorur afatin e pëershpejtuar për vlere te madhe (mbi 500.000€) e qe me rregullore afati minimal është 15 dite, Pra afati prej 17 dite është ne përputhje me rregullore te prokurimit publik e qe kjo është bere qe te respektoj te gjitha afatet ligjore qe përfshihen pas hapjes se tenderit. Afatet e vlerësimit, kërkesave për sqarime gjate vlerësimit, kërkesave eventuale për rishqyrtim si dhe afateve kohore ne rast te ndonjë ankesë ne OSHP nga OE. Pra ne rastin konkret është llogaritur qe te kemi kontrate sipas planeve te remonteve.	Komenti nuk është relevant dhe gjetja qëndron. Ligi i prokurimit publik, nuk e lejon shkurtimin e afateve minimale të përcaktuara më ligj dhe kjo situatë nuk kishte të bënte me situata ekstreme emergjente që nuk mund të parashikohen nga entiteti por më një mos planifikim të duhur të kohës së kryerjes së projekteve kapitale.
Mos rivlerësimi periodik i pasurive afatgjata që mbahen në regjistër sipas modelit të rivlerësimit	Menaxhmenti, ka rivlerësuar kategorinë e Tokave ne përputhje me kërkesat e SNRF-ve duke përdorur resurse te brendshme pa shkaktuar kosto shtese. Nga ky rivlerësimi vlera e Tokave është shtuar për 50 milion. Per kategoritë tjera te aseteve, konsiderojmë qe modeli i Kostos është shumë me i përshtatshëm dhe prezanton drejt gjendjen e aseteve te Korporatës dhe kjo për arsyet me poshtë: Qasja e bazuar ne Kosto: Metoda e rivlerësimit përfshin vlerësimin e aseteve me vlerën e tyre të drejtë, e cila mund të mos jetë praktike ose domethënëse për lloje të caktuara asetesh, si termocentralet dhe pajisjet e përdorura në prodhimin e energjisë elektrike. Luhatshmëria: Metoda e rivlerësimit mund të sjellë paqëndrueshmëri të konsiderueshme në pasqyrat financiare. Ndryshimet e vlerës së drejtë, veçanërisht për aktivet me jetëgjatësi si termocentralet, mund të	Komenti nuk është relevant dhe gjetja qëndron. Rekomandimi është dhënë për pjesën e pasurisë që mbahen në libra sipas vlerës së drejtë (Metoda e rivlerësimit). Kompania kishte kryer rivlerësimin e pasurisë në vitin 2004 dhe vlera e pasurive prej 9.8 milion euro mbahet në libra në bazë të raportit të vlerësuesit të pavarrur atëherë sipas SNK 16, duhet të rivlerësimet duhet të kryhen në frekuencë të rregullta, të mjaftueshme në mënyrë që vlera e drejtë të jetë e përafërt me vlerën e tregut. Sa i përket pasurive në përdorim më vlerë neto në libra zero (0.00), SNK 16, tek pjesa Shuma e amortizueshme dhe periudha e amortizimit ndër të tjera thekson se shuma e amortizueshme e një aktivit do të shpërndahet mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Jeta e dobishme e një

<p>Iuhaten për shkak të ndryshimeve në kushtet e tregut, përparimeve teknologjike ose faktorëve rregulator.</p> <p>Mqedisi Rregulator: Kompanitë e prodhimit të energjisë elektrike operojnë në një mjedis të rregulluar, ku tarifat dhe të ardhurat përcaktohen nga organet rregulatorore bazuar në formula të paracaktuara ose mekanizma të mbulimit të kostos. Në raste të tillë, edhe pse ne forme indirekte tek KEK, metoda e rivlerësimit mund të mos përputhet me kuadrin rregulator dhe aplikimi i matjeve të vlerës së drejtë mund të rezultojë në një mospërputhje midis vlerave të raportuara dhe kërkesave rregulatorore.</p> <p>Sfidat praktike: Zbatimi i metodës së rivlerësimit kërkon ekspertizë të konsiderueshme, burime dhe vlerësimë të vazhdueshme të vlerësimit.</p> <p>Menaxhmenti, ne përputhje me kërkesat e SNRF-ve, ne baza te rregullta vjetore ka kryer testimin e aseteve për dëmtim duke krahasuar kështu vlerën neto te aseteve me fitimin neto te diskontuar qe do gjenerojne këto asete ne vitet ne vijim. Bazuar ne këto testime te kryera vlera neto e aseteve nuk dallon materialisht nga fitimi neto qe pritet te gjenerohet ndër vite qe le te nënkuqtoj qe asetat prezantojnë vlerën e tyre reale dhe qe nuk ka nevojë te kryhen korrigjim ne vlerën bartëse te tyre.</p> <p>Për me tepër, KEK ka kontrata ekzistuese për realizimin investimeve kryesore, përfshirë modernizimin e bloqeve B1 dhe B2 qe paraqet asetin kryesor qe gjeneron te hyra për Korporatën, po ashtu janë ne proces te tenderimit rehabilitimi i njësive te termocentralit Kosova A, investimet ne miniera etj. Tokat ne mihi mbahen sipas kostos historike dhe menaxhmenti nuk e ka parë të arsyeshme të rivlerësoj edhe kategorinë e tokave për mihje, pasi që edhe zhvli. i tyre bëhet bazuar në planin operativ të kompanisë për shfrytëzimin e rezervave të thëngjillit</p>	<p>aktivit përcaktohet në termat e dobishmërisë së pritshme të aktivit për njësinë ekonomike. Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e një aktivit kërkohet të rishihet të paktën çdo fund-viti financiar dhe nëse pritshmëria ndryshon nga parashikimet e mëparëshme, ndryshimet do të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël në përputhje me SNK 8 Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet.</p> <p>Prandaj, kompania gjeneron të hyra nga pasuritë më vlerë zero në libra dhe Menaxhmenti është në dijeni se vlera e tyre në treg është me e lartë se zero duhet të kryhet një vlerësim për të përcaktuar vlerën e tyre të drejtë duke mundësuar prezantimin e saktë dhe të drejtë të gjendjes së pasurive afatgjata të kompanisë.</p>
---	---

	<p>dhe vlera e mbetur-zero për 296 asete të kësaj kategorie, pasqyron vlerën e drejtë deri në rivitalizimin e tyre nga KEK për ndonje qëllim tjeter të shfrytëzimit. KEK konsideron qe rekomandimin për rivlerësimin e aseteve e ka te implementuar me rivlerësimin e kryer për kategorinë e tokave.</p> <p>Sa i përket 71% te numrit te aseteve me vlere kontabël zero, SNRF nuk kërkon që vlera kontabël e një aseti të mbahet në një shumë pozitive për sa kohë që ajo paraqitet dhe shpaloset në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare. Është thelbësore të jepet informacion shpjegues për ekzistencën dhe natyrën e aseteve të tilla në shënimet e pasqyrave financiare. Është e rëndësishme të theksohet se ndërsa asetet me vlerë kontabël zero mund të janë ende në përdorim, KEK ka kosto te mirëmbajtjes për këto aseteve, dhe kjo kosto përkon me te hyrat qe realizohen nga përdorimi i aseteve me vlere kontabël zero, për me tepër qe 70% e vlerës se këtyre aseteve janë asete te cilat duhet te kenë vlerën neto zero. Prandaj, konsiderojmë qe kjo gjetje nuk qëndron dhe njëkohësisht është rekomandim jo praktik te implementohet tek pjesa e aseteve kryesore qe janë pajisjet e prodhimit.</p>	
Mos përditësimi i regjistrat të pasurisë me ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme	<p>Sipas Kornizës Konceptuale për raportim financiar - IFRS, njësia ekonomike e njeh një aset si burim ekonomik, nëse plotësohen 3 aspektet bazë të përkufizimit: a) E drejta, b) mundësia për të marr përfitime ekonomike dhe c) kontrolli mbi atë aset.</p> <p>KEK SH.A. ka bërë përditësimin e regjistrat të pasurisë konform kërkesave për raportim financiar, siç përcaktohet në Kornizën e lartcekur dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.</p> <p>a) Tokë ndërtimore 1.72 ha - kompania ka bërë përditësimin e regjistrat, vetëm për pjesën e tokës 15.91 ari të cilën e shfrytëzon dhe ka kontroll mbi të;</p>	<p>Komenti nuk është relevant dhe gjetja qëndron.</p> <p>Për më tepër, kjo gjetje është e përsëritur nga viti i kaluar për të cilën menaxhmenti ishte pajtuar në raportin e vittit 2022.</p> <p>Menxhamanti përkundër disa veprimeve që ka marrë lidhur më këtë çeshtje duhet të rris përpjekjet për të siguruar plotësinë dhe saktësinë e regjistrat për pronat pa luajtshme.</p> <p>Ne vlerësojmë së menaxhmenti duhet të bëjë një rishikim të përgjithshëm të pronave te paluajtshme dhe të përditësoj regjistrin e pasurisë me gjendjen</p>

<p>b) Toke 116.88 hektar në zonën kadastrale Vasilevë - KEK ka përfshirë në regjistrin e aseteve vetëm pjesën e parcelës prej 61.18 ha, mbi të cilën ka të drejtën ligjore dhe kontrollin, ndërsa për sipërfaqen 55.70 ha kompania ka filluar procedurën ligjore, pasi sipas certifikatës së pronësisë është në emër të Agjencisë Pyjore të Kosovës. KEK.sha me dt.18.01.2024 ka ushtruar padi ndaj KK-Gllogoc, me objekt kontesti bartja e pronësitë, ngase në procedurë të rregullt administrative KK-Gllogoc nuk i ka bartur këto prona në emër të KEK.sha sipas vendimeve të eksproprijimit.</p> <p>c) Lokali afarist 140 m² - bazuar në përkufizimin e një aseti, kompania nuk ka mundësinë e shfrytëzimit (përfitimeve ekonomike) dhe kontrollin mbi këtë aset, prandaj dhe nuk është përfshirë në regjistrin e pasurisë. Jemi në proces të përbartimit të lendes gjyqësore, me saktësish jemi në pritje të vendimit nga Gjykata që është duke zhvilluar procedura përbartimore. Se fundi kemi pranuar Aktgjykimin nga Gjykata Supreme Rev.E.nr.16/2024 dt.24.04.2024 për çështjen juridike te palës ndërgjegjese "Epoka e Re", ku në bazë të këtij Aktgjykimi Refuzohet Revizioni i palës se paditur "Epoka e Re". Pas pranimit të këtij Aktgjykimi nga Gjykata Supreme kemi dërguar urgjencë në Gjykatën që është duke u zhvilluar procedura përbartimore, duke ja bashkangjitur Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.E.nr.16/2024, ngase njëra nder arsyet që pala e paditur - debitorit "Epoka e Re" ka bërë prapsim është edhe dërgimi i kësaj çështje gjyqësore në Gjykatën Supreme.</p> <p>d) Tokat ne Podujeve-Infrakos (5) - Kemi parashtruar padi me nr. KP.nr.23/24 në Gjykatën Komerciale të Kosovës me dt.10.05.2024, ndaj ndërmarrjes Infrakos sha. me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë dhe sigurimi i para provës për parcelat që pretendohen që kanë kaluar nga</p>	<p>faktike. Po ashtu, edhe në komentin e entitetit siç shihet ekzistojnë pa qartësi sa i përket të drejtave dhe detyrimeve ndaj pronave, andaj kjo ndikon që prezantimi i gjendjes së pronave të jetë jo i plotë në raportim dhe mund të ketë ndikim material në prezantimin e saktë dhe të drejtë të gjendjes së pasurive afatgjata të kompanisë.</p>
---	--

	<p>KEK.sha në Infrakos sha, sipas vendit të Qeverise të vitit 2010 dhe marrëveshjes në mes infrakos .sha dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në vitin 2012. Gjykata Komerciale me dt.04.06.2024 e ka aprovuar propozimin tonë për caktimin e ekspertizës se gjeodezisë me paraprovë dhe jemi në pritje të kësaj ekspertize gjyqësore.</p> <p>e) Pronat (11) te cilat janë private - Keto prona kane qe te propozuara per shlyerje nga menaxhmenti tek Bordi. Bordi ne baze te vendimit nr.1612 te datës 14.03.2024 ka kërkuar qe fillimisht te sigurohet historiati i këtyre pronave deri me datën 30.06.2024 dhe pastaj te vendoset per shlyerje a po jo. Kemi dërguar kërkesat tek Komuna e Podujeves dhe e Obiliqit. Nga Komuna e Podujeves kemi pranuar konfirmimin se toka ne fjale nuk ka qene asnjëherë ne pronësi te KEK-ut, kurse nga Komuna e Obiliqit kemi pranuar konfirmimin se tokat ne fjale nuk janë ne pronësi te KEK-ut. Ky dokumentacion do te dërgohet tek bordi per shqyrtim dhe per aprovim te shlyerjes nga regjistrat e Kompanisë.</p> <p>Menaxhmenti, duke u bazuar ne faktet e prezantuara me larte, dhe kërkesat e SNRF-ve, asnjë nga çështjet e ngritura ne opinion nuk kane efekt ne pasqyrat financiare te Korporatës prandaj dhe si te tilla nuk munde te përbejnë baze për opinion ne pasqyrat financiare.</p>	
Mangësi tek procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë	<p>a) Sa i përket Përshkrimit te Çmimit ne aktivitetin e Prokurimit "Modernizimi i turbinave ne TCB", ne dosje te tenderit është kërkuar përshkrim me i detajuar i çmimeve për njësi por ofertuesi ka dorëzuar përshkrimin e çmimit përmbledhës dhe gjate negociatave është kërkuar edhe njëherë qe te dorëzohet përshkrimi i çmimit me i detajuar. Ofertuesi ka deklaruar se nuk ka mundësi te ofrohen çmimet sipas formatit te dhënë ne dosje te tenderit. Marre parasysh se procedura e prokurimit ka qene e negociuar dhe me ketë procedure</p>	<p>Komenti nuk është relevant dhe gjetja qëndron.</p> <p>a) Entiteti ka dhënë arsyetimet lidhur me zhvillimin e procesit të prokurimit ndërsa çështja është trajtuar nga aspekti i respektimit të kushteve të parapara në dosjen e tenderit. Pra, oferta financiare-përshkrimi i çmimit ishte dorëzuar nga operatori ekonomik në çmime totale për komponentë dhe siç kërkuar në dosje të tenderit çmime për njësi për secilin pozicion të paraparë në paramasë. Ndërsa lidhur me vërtetimin tatimor, me rastin e nënshkrimit të kontratës vërtetimi</p>

<p>është e lejuar te negociohen te gjitha kushtet e dosjes se tenderit dhe bazuar qe propozimi i përshkrimit te çmimit ka qene i pranueshëm për Autoritetin Kontraktues dhe ka vlerësuar se nuk paraqet problem ne implementimin e kontratës, konform dispozitave te legjislacionit për prokurim publik është pranuar oferta si e përgjegjshme dhe ka vazhduar ne nënshkrimin e kontratës. Sa i përket vërtetimit tatimor, Zyra e Prokurimit edhe njëherë konstaton se vërtetimi është dorëzuar konform kërkesave te Ligjit te Prokurimit Publik. Ofertuesi ka dorëzuar vërtetimin e Administratës Tatimore te datës 05.10.2022, me te cilin mbulon tremujorin qershorshtator/2022. Meqenëse ftesa per negocim është dorëzuar me daten 09.12.2022, tremujori paraprak përkëtë aktivitet te prokurimit për çështjen e tatimeve është tremujori III-te (qershorr-korrik) dhe ne ketë rast vërtetimi tatimor është dorëzuar ne pajtim me nenin 65, paragrafin 5 te LPP-se "Periudhat kohore të përcaktuara në këtë Nen ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin ftesës për pjesëmarrje ose tenderim."</p> <p>b) Zyra e Prokurimit bene përpjekje te vazhdueshme qe te evitoj përdorimin e procedurave te negociuara per situate emergjente si dhe ne disa raste per shkak te detyrimeve teknike.</p> <p>Procedura e negociuar për shërbimet "Ruajtja dhe sigurimi i objekteve të kompanisë" ka ardhur si rezultat sepse procedura e hapur per kontrate kornize njëvjeçare per shkak te ankesave ne OSHP dhe kur kemi një aktivitet te njëjtë nuk mund te përdorim procedure te hapur atëherë jemi te detyruar qe per te mos mbetur pa kontrate qe te përdorim procedure te negociuar. Gjithashtu edhe për shërbimet "Sigurimi shëndetësor për punëtorët e KEK-ut" përderisa nuk kemi</p>	<p>nuk kishte validitet (vërtetimi ishte dorëzuar me 05.10.2022 me vlefshmëri 90 ditë ndërsa kontrata kontrata është nënshkruar me 24.02.2023).</p> <p>b) Entiteti ka shpjeguar rrethanat që kanë shpie në përdorimin e kësaj procedurave me negocim mirëpo ne konsiderojmë, kjo situatë ishte ardhur si rrjedhojë e mos planifikimeve të duhura nga njësitë kërkuese dhe zyrës së prokurimit lidhur me zhvillimin e aktiviteteve të parapara të prokurimit. Po ashtu, edhe KRPP në tre prej këtyre rasteve kishte dhënë opinion se rrethanat e tillë më shumë i atribuohen mos planifikimit të duhur dhe neglizhencës nga Autoriteti Kontraktues se sa që kanë të bejnë me situata ekstreme emergjente.</p>
---	--



	<p>kontrate kornize një apo tri vjeçare kemi proceduar me procedure te negociuar per te mos lënë punëtorët pa sigurim shëndetësor.</p> <p>Shërbimi “Transporti i punëtorëve te KEK-ut” gjithashtu per shkak te ankesave ne OSHP Zyra e prokurimit jemi detyruar te përdorim procedure te negociuar per te mos mbetur pa këtë shërbim për punëtorët.</p> <p>Përdorimi I procedurës se negociuar për furnizim me mazut, furnizim me acid klorhidrik, etj janë si rezultat I ankesave ne OSHP dhe duke ditur se këto janë furnizime qe pa to nuk mund te funksionojnë termoelektranat jemi te detyruar qe ne mungese te kontratave kornize per këto furnizime e përdorim procedure te negociuar.</p> <p>Përdorimi I procedurës për “Shërbime për zhvendosjen fizike dhe ekonomike për një pjesë të fshatrave të Komunës së Obiliqit” ka ardhur nga dështimi I procedurës se hapur te kufizuar e cila nuk mund te vazhdoj nëse ne fazën e pare nuk I kemi tre ofertues te përgjegjshëm për te vazhduar me fazën e dyte dhe për te ardhur deri te nënshkrimi dhe realizimi I kontratës.</p>	
Nënshkrimi i kontratës për auditimin e Pasqyrave Financiare	<p>Auditimi i Pasqyrave Financiare te shoqërive tregtare rregullohet me ligjin NR. 06/L- 032 PËR KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM; Kërkesat ligjore qe rrjedhin nga ky ligj janë te obligueshme edhe për Ndërmarrjet Publike te cilat për me tepër kane kërkesa shtese ne lidhje me raportimin financiar dhe auditimin.</p> <p>Për këtë çështje KEK ka adresuar shqetësimin edhe tek KKRF dhe ZKA dhe nga përgjigjet e marra nga te dyja palët, KKRF qe KEK obligohet te kryej auditimin sipas SNA-ve nga një firme e pavavarur e licencuar e auditimit dhe te dorëzoj raportin jo me vone se 30 Prill (kërkesë ligjore), dhe përgjigja e ZKA qe këto kërkesa ligjore ZKA nuk munde t'i përbushë, KEK ka</p>	<p>Komenti nuk është relevant dhe gjetja qëndron.</p> <p>ZKA sipas procedurave të përcaktuara ligjore ka njoftuar më kohë entitetin dhe përmes letër angazhimeve 2022 dhe 2023 ka përcaktuar që do të kryej auditimin e pasqyrave financiare të përgatitura për qëllime të përgjithshme bazuar në SNK/SNRF duke dhënë opinion mbi pasqyrat financiare dhe konkluzion për pajtueshmëri. Edhe përkundër që ne kemi kryer auditimin në bazë të mandatit kushtetues , Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm, entiteti ka angazhuar auditorin privat për objektivin e njëjtë- auditim i pasqyrave financiare.</p>

vazhduar me kontraktimin e auditimit sipas kërkeseve ligjore. Për me tepër ZKA ka dekluaruar qe përveç mos përbushjes se kërkeseve ligjore qe rrjedhin nga ligji NR. 06/L-032 PËR KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM, po ashtu nuk mund te përbushë kërkesat ligjore që rrjedhin nga Neni 4 i Licencës për prodhimin e energjisë elektrike dhe në harmoni me Ligji Për Regulatorin e Energjisë 05-L-084, jo me vone se 31 Mars i vitit vijues për vitin paraprak dhe; Kërkesat sipas ligjit Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, Neni 34 Të drejtat dhe detyrimet e Licencës për shfrytëzim, paragrafi 4.2.2, jo me vone se 28 Shkurt e vitit vijues për vitin paraprak.

Për me tepër, ne shkresat e pranuara nga ZKA, vet pranon faktin qe janë te nevojshme ndryshimet ligjore ne mënyrë qe ne te lirohem i nga këto obligime, gjithsesi këto ndryshime ligjore nuk kane ndodhur dhe KEK mbetet e obliguar ligjërisht t'i implementoje kërkesat qe rrjedhin nga këto ligje (shih bashkangjitur shkresat).

Prandaj, duke pasur ne konsiderate edhe komunikimet qe janë fakte te pa mohueshme ne këtë çështje, KEK konsideron qe kjo gjetje nuk mund te jete pjese e raportit dhe paraqitja e kësaj gjetje është ne kundërshtim me kërkesat ligjore qe KEK obligohet t'i përbushë.

Për me tepër, kjo si e gjetur nuk është prezantuar vitin e kaluar (2022) dhe ka qene plotësisht e njëjtë situate.



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft reportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të "Korporata Energjetike e Kosovës" sh. a., për vitin 2023 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem vetëm me gjetjet A4, B1 dhe C3 ndërsa për gjetjet dhe rekomandimet tjera, kemi paraqitur komentet në dokumentin e bashkangjitur si Shtoja A.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z.Arton Ahmeti

Kryesues i Bordit të "Korporata Energjetike e Kosovës" sh. a.,

Data: 25.06.2024, Prishtine



Shënimet fundore

¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.

² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

15 -03- 2024

Nr. 1664/1
PRISHTINË - A



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.

**Pasqyrat Financiare për vitin që
përfundon më 31 Dhjetor 2023**

PËRMBAJTJA

FAQË

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	8
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	9
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	10
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	11
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	12

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Më 31 Dhjetor 2023

Shënimet	Më 31 Dhjetor 2023 (në EUR '000)	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR '000)	Riparaqitur 1 Janar 2022 (në EUR '000)
PASURITË			
Pasuritë afatgjata			
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	273,734	232,734
Depozitat ne banka - pjesa afatgjate	9	80,900	96,900
Investimet ne letra me vlerë- afatgjate	10	16,012	0
Pasuritë e paprekshme	5	386	618
Gjithsej Pasuritë afatgjata		371,032	330,252
Pasuritë afatshkurtra			271,750
Inventarët	6	19,258	20,831
Të arkëtueshmet tregtare dhe tjera, neto	7	57,813	77,935
Paraja në dorë dhe në bankë	8	48,365	97,127
Depozitat ne banka - pjesa afatshkurtër	9	72,721	48,500
Të arkëtueshmet e shtyera të prodhimit të energjisë		0	2,313
Investimet ne letra me vlerë- afatshkurtër	10	34,296	0
Tatimi ne te ardhura i arketueshem		134	0
Gjithsej Pasuritë afatshkurtra		232,587	246,706
GJITHSEJ PASURITË		603,619	576,958
EKUITETI DHE DETYRIMET			459,411
Ekuiteti i aksionarëve			
Kapitali aksionar	12	25	25
Rezervat	13	251,507	198,472
Fitimet / (Humbjet) e akumuluarë		127,080	113,890
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve		378,612	312,387
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huazimet - pjesa afatgjatë	13	103,992	115,380
Grantet e shtyera	14	6,049	8,211
Provizionet	15	55,754	56,193
Detyrimet e tatimit të shtyrrë	25	9,648	9,648
Detyrimet afatgjata		175,443	189,432
Detyrimet afatshkurtra			204,034
Huazimet - pjesa afatshkurtër	13	11,996	12,026
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	16	12,816	21,755
Tatimi mbi të ardhura i pagueshëm		-	7,759
Grantet e shtyera - Importi i Energjisë	14.1	17,825	27,012
Te pagueshmet e shtyera të prodhimit të energjisë		1,473	16,648
Shpenzimet akruale	17	5,454	6,587
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		49,564	75,139
Gjithsej detyrimet		225,007	264,571
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		603,619	576,958
			459,411

Këto pasqyra financiare t'pa audituara janë aprovuar nga Bordi i Drejtoreve dhe të nënshkuara në emër të tyre më 15 mars 2024:

Z. Bekir Gërguri

UD Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv



Z. Gramos Hashaqi

Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruuese të faqeve 12 deri 52 te cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfsirëse
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023

Shënimet	Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2023 (në EUR '000)	Riparaqitur Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2022 (në EUR '000)
Të hyrat nga shitja e rrymës	18	180,824
Të hyrat nga grantet	19	11,559
Të hyrat tjera	20	796
		193,179
		307,961
SHPENZIMET OPERATIVE		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	(47,809)
Shpenzimet e personelit	21	(47,933)
Energjia elektrike dhe komunalitë	22	(37,568)
Kostot e mirëmbajtjes		(3,618)
Materialet dhe furnizimet		(6,569)
Shpenzimet e linjës		(21,225)
Provizonimet për shlyerjen e inventarit		3,122
Humbjet nga zhvlerësimi/Lirim i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera		(972)
Ndryshimi në provizione	15	(2,671)
Shpenzimet e shtyera të prodhimit të energjisë		(3,786)
Shpenzimet e tjera operative	23	(9,617)
		(178,646)
		(190,913)
Fitimi nga operacionet		14,533
		117,048
Te hyrat / (Shpenzimet) financiare, neto	24	2,434
Fitimi para tatimit		16,967
		118,545
Shpenzimet e tatimit në fitim	25	(3,777)
Fitimi neto për vitin		13,190
		104,920
Të ardhurat tjera gjithëpërfsirëse për vitin		
Zërat që nuk do të riklasifikohen në fitim dhe humbje		
Efekti i tatimit të shtyer në rivlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve	26	0
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfsirëse për vitin		13,190
		105,544

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 12 deri 52 te cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Pasqyra e ndryshimeve në Ekuitet
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023

	Kapitali aksionar (në EUR' 000)	Rezervat (në EUR' 000)	(Humbjet) e akumuluara (në EUR' 000)	Gjithsej (në EUR' 000)
Gjendja më 01 Janar 2022	25	197,848	9,091	206,964
Gjendja e riparaqitur me 01 Janar 2022	25	197,848	8,970	206,843
Transaksionet me pronarët				104,920
Dividentat				104,920
Fitimi i vittit		624		624
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		624	104,920	105,544
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		25	198,472	113,890
Gjendja më 31 Dhjetor 2022				312,387
Gjendja me 01 Janar 2023	25	198,472	113,890	312,387
Transaksione me pronarin				
Transaksione me pronarin				13,190
Fitimi për vitin		53,035		53,035
Fitimi nga rivleresimi				
Te hyra tjera gjithëpërfshirëse				
Total te hyra tjera gjithëpërfshirëse		53,035	13,190	66,225
Gjendja Me 31 Dhjetor, 2023	25	251,507	127,080	378,612

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 12 deri 52 te cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Pasqyra e rrjedhës së parasë
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023

	Shënimet	Për vitin e mbyllur më 31.12.2023 (në EUR '000)	Riparaqitur Për vitin e mbyllur më 31.12.2022 (në EUR '000)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi neto para tatimit		16,967	118,545
Rregullimet për zërat jomonetar			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	47,809	48,462
Amortizimi i granteve	18	(11,559)	(22,245)
Të hyrat nga interesi	23	(6,377)	(5,403)
Shpenzimet e interesit	23	3,962	3,906
Provizonimi i borxheve të këqija	28.B	972	4,500
Provizonimi për kostot e mjedisit dhe pensioneve	14	2,671	(423)
Provizonimi për shlyerjet/kthimet e inventarëve	6	(3,122)	216
Rregullimi per energjinë e shkëmbyer		3,786	
Shlyerja e pronës, impianteve dhe paisjeve	4,5	44	44
Fitimi para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative		55,153	147,602
Inventarët			
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		1,549	(758)
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera		25,546	(24,490)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		(14,552)	13,040
Interesi i arkëtar		67,378	135,394
Interesi i paguar		4,205	
Tatimi mbi të ardhura i paguar		(3,035)	(2,956)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		(11,670)	(10,933)
		56,878	121,505
Paraja nga aktivitetet investive			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	4,5	(35,085)	(10,108)
Zvogëlim/(Rritje) në depozita		(58,529)	(145,400)
Paraja (e përdorur) në aktivitetet investive		(93,614)	(155,508)
Paraja nga aktivitetet financiare			
Grantet e pranuara për importin e energjisë		0	30,000
Dividenda e paguar		0	-
Pagesa e huazimeve		(12,026)	(11,387)
Paraja (e përdorur) në aktivitetet financiare		(12,026)	18,613
Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentët e parasë		(48,762)	(15,390)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		97,127	112,517
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	8	48,365	97,127

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 12 deri 51 te cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023

1. INFORMATAT TË PËRGJITHSHME

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. ("Kompania" ose "KEK") është shoqëri aksionare inkorporuar në Kosovë dhe e regjistruar nën Agjencinë e Regjistrimit të biznesit në Kosovë nën numrin e regjistrimit 7032599 me datë 27 dhjetor 2005. Kompania u transformua në një ndërmarrje aksionare (Sh.A.) nën Misionin e Administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara ("UNMIK") rregullorja nr. 2001/6. Adresa e selisë qendrore së saj të regjistruar është: Rruga Nënë Tereza Nr. 36, 10 000 Prishtinë, Kosovë.

Kapital fillestar i regjistruar i Kompanisë arrin në 25 mijë euro. Librat e Kompanisë janë hapur që nga 1 janari 2005 bazuar në Raportin e Due-Diligence Financiare sipas dates 01 janar 2005 nga një vlerësues i pavarur.

Kompania është 100% në pronësi të Republikës së Kosovës.

Aktivitetet kryesore të Kompanisë janë gjenerimi energjise dhe aktivitetet minerare si nxerrja e linjtit duke përdorur termocentralet e tij.

Struktura aktuale operative e Kompanisë përbëhet nga zyra qendrore e korporatës dhe divizionet e mëposhtëm:

- Divizioni i prodhimit të Linjtit;
- Divizioni i prodhimit të energjisë - Kosova A;
- Divizioni i prodhimit të energjisë - Kosova B;

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i prodhimit (KEK SHA) - TC Kosova A për prodhimin e energjisë elektrike zgjatet për periudhën nga 4 tetor 2023 deri më 4 tetor 2023 (numri i licencës ERO / Li_05 / 17_A) nga Zyra e Rregulatorit të Energjisë. Për shkak të paaftësisë së Kompanisë për të marrë Lejen e Integruar Mjedisore nga MMPH licenca për Kosovën A rinovalohet çdo vit.

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i prodhimit (KEK SHA) - TC Kosova B për prodhimin e energjisë elektrike zgjatet për periudhën nga 4 tetor 2006 deri më 4 tetor 2026 (numri i licencës ERO / Li_05 / 17_B) nga Zyra e Rregulatorit të Energjisë.

Ndërsa më 13 prill 2017, Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A), Divizioni i Prodhimit "TC Kosova B", me numër licence ZRRE / Li_05 / 14_B, është modifikuar në "Licencë e Kogjenerimit të Energjisë Elektrike dhe Termike" me numër të ri licence ZRRE / Libp_05 / 17_B lëshuar nga Zyra e Rregulatorit të Energjisë (ZRRE), të gjitha dispozitat e tjera të licencës së mëparshme mbeten në fuqi.

Ndërsa më 20 dhjetor 2018, Korporatës Energjetike të Kosovës ishte pajisur me licencen e re ERO/ Li_60 / 17 për Furnizim me Energji Elektrike me vlefshmëri nga 20 dhjetor 2018 deri më 19 dhjetor 2043.

Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SHA) gjatë dhjetorit 2014 filloi projektin për Kogjenerimin e Energjisë Termike ku energjia termike i shitet Termokos Sh.A me qëllim të sigurimit të furnizimit me ngrohje në Prishtinë.

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB").

2.2 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përvèç për Pronat, impiantet dhe pajisjet e blera para vitit 2005 të cilat mbahen me vlerë të drejtë, të cilat konsiderohen të jenë kosto në vitin e inkorporimit.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

2.3 Supozimi i parimit të vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë.

2.4 Valuta funksionale dhe prezentimit

Valuta funksionale dhe raportuese e Kompanisë është euro (EUR) e cila është në pajtueshmëri me rregullativat e Unionit Monetar European dhe udhëzimet e lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, valuta euro është adoptuar si valutë e vetme legale në territorin e Kosovës që nga 1 janari 2002.

Pasqyrat financiare janë përgaditur për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të deklaruara në këto pasqyra financiare janë të shprehura në mijëra euro, përvèç nëse kërkohet të janë të shprehura ndryshe. Sipas nevojës, figurat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet e prezantimit për vitin.

2.5 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet e denominated në valuta ndryshe nga euro janë të regjistruara në kursin e këmbimit që vendoset në datën e transaksionit. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të ndryshme nga euro, përfshihen në fitimin ose humbjen duke përdorur kursin e këmbimit që vendoset në atë datë.

Pasuritë dhe detyrimet të valutës monetare ndryshe nga euro përkthehen me kursin e këmbimit të tregut të mesëm në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në kurset e këmbimit pas datës së transaksionit njihen në fitim ose humbje pasi përkthimi i këmbimit valutor fiton më pak humbje.

2.6 Prona, impiantet dhe paisjet

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve më 1 Janar 2005 janë riparaqitur me koston e konsideruar zvogëluar zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimin, ndërsa zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve të blera mbas periudhës 1 janar 2005 paraqiten me kosto zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimin, nëse ka.

Kostoja e konsideruar përfaqëson vlerat fillestare të pasurive të vlerësuara nga Kompania me ndihmën e një konsulenti të pavarur në kohën e shndërrimit nga një Korporatë në një Shoqëri Aksionare, më 1 janar 2005.

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i ngarkohen fitimit ose humbjes gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin.

Toka dhe pyjet mbahen sipas kostos se vlerësuar dhe nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi në pasuritë e tjera është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë kostot e tyre ose shumat e rivteresuara të vlerave të mbetur mbi jetën e përdorimit të parashikuar, si vijon:

	2023	2022
Toka në miqje	2-7 vite	2-7 vite
Ndërtesat	10-50 vite	10-50 vite
Pajisjet e rënda industriale	10-50 vite	10-50 vite
Automjetet	10-50 vite	10-50 vite
Mobilje, armature dhe pajisje	10-50 vite	10-50 vite

Vlera e mbetur e pasurive dhejeta e përdorimit janë rishikuar dhe rregulluar nëse ka qenë e përshtatshme, në secilën datë të pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera bartëse e një pasurie është rritur menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël e pasurisë është më e madhe se shuma e vlerësuar e rikuperueshme.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

Fitimet dhe humbjet nga shitja janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitim ose humbje.

2.7 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të kufizuar të cilat fitohen veçmas, mbarten me kosto zvogëluar amortizimin e akumuluar dhe humbje të akumuluara nga dëmtimi. Amortizimi njihet mbi baza lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar.

Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësim, të cilat llogariten mbi bazën e ardhshme.

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të papercaktuar që janë fituar veçmas, mbarten me kosto zvogëluar humbjet e akumuluara nga dëmtimi.

2.8 Mosnjohja e pasurive të paprekshme

Një pasuri e paprekshme nuk njihet në shitje ose kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi ose shitja. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një pasurie të paprekshme, maten si diferenca midis fitimit të asgjësimit neto dhe vlerës së mbartur të pasurisë, njihen në fitim ose humbje kur pasuria është çregjistruar.

2.9 Dëmtimi i pasurive jo - financiare

Në secilën datë të raportimit, Kompania rishikon vlerat kontabël të pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikacion që ato pasuri kanë pësuar një dëmtim nga humbjet. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet të përcaktojë masën e humbjes së dëmtimit (nëse ka). Kur pasuria nuk gjeneron fluks të parave që janë të pavarura nga pasuritë e tjera, Kompania vlerëson shumën e rikuperueshme të njësisë gjeneruese të parave të cilës i përket pasuria. Kur mund të identifikohet një bazë e arsyeshme dhe e qëndrueshme e alokimit, pasuritë e korporatave u shpërndahen edhe njësive individuale të gjenerimit të parave, ose përndryshe ato shpërndahen në grupin më të vogël të njësive gjeneruese të parave për të cilat mund të identifikohet një bazë e arsyeshme dhe e qëndrueshme të alokimit.

Shuma e rikuperueshme është më e lartë se vlera e drejtë minus kostot e nxjerjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara të parave zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritje para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike për pasurinë për të cilin vlerësimet e flukseve të ardhshme të parave nuk janë rregulluar.

Nëse shuma e rikuperueshme e një pasurie (ose njësi gjeneruese të parave të gatshme) vlerësohet të jetë më e vogël se vlera e tij kontabël, vlera kontabël e pasurisë (ose njësia gjeneruese e parave të gatshme) zvogëlohet në shumën e rikuperueshme. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim ose humbje, përvèç nëse pasuria përkatëse mbahet me një shumë të rivlerësuar, në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si një rivlerësim dhe në atë masë që humbja e dëmtimit është më e madhe se teprica e rivlerësimit të lidhur, humbja e tepërt nga dëmtimi njihet në fitim ose humbje.

Kur një humbje nga dëmtimi shfuqizon më pas, vlera kontabël e një pasurie (ose njësia gjeneruese e parave të gatshme) është rritur në vlerësimin e rishikuar të shumës së rikuperueshme të tij, por në mënyrë që vlera e shtuar kontabël të mos kalojë vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar nuk do të kishte asnjë

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023

2. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

humbje nga dëmtimi që do ishte njojur për pasurinë (ose njësinë gjeneruese të parave të gatshme) në vitet e mëparshme. Një kthim i humbjes nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim ose humbje në atë mënyrë që eliminon humbjen nga dëmtimi i cili është njojur për pasurinë në vitet e mëparshme. Çdo rritje më të madhe se kjo shumë është trajtuar si një rritje të rivlerësimit.

2.10 Investimet në burimet minerale

Një entitet trajton pasuritë e kërkimit dhe vlerësimit si një klasë e veçantë të pasurive dhe jep informacionet shpjeguese të kërkua nga SNK 16 Pronë, Impianti dhe SNK 38 Pasuritë e paprekshme.

Kompania i klasifikon pasuritë e kërkimit dhe vlerësimit si të prekshme ose të paprekshme sipas natyrës së pasurisë të fituar dhe aplikon klasifikimin në mënyrë të vazhdueshme.

Një pasuri e eksplorimit dhe vlerësimit nuk klasifikohet më si i tillë kur fizibiliteti teknik dhe qëndrueshmëria tregtare e nxjerrjes së një burimi mineral janë të demonstrueshme. Pasuritë e kërkimit dhe vlerësimit vlerësohen për dëmtim, dhe çdo humbje nga dëmtimi e njojur, para riklasifikimit.

Shpenzimet që nijhen si pasuri kërkimore dhe vlerësuese përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në to:

- fitimi i të drejtave për të eksploruar;
- studime topografike, gjeologjike, gjeokimike dhe gjeofizike;
- shpimi eksplorues;
- gërmimi;
- mostra; dhe
- aktivitete në lidhje me vlerësimin e fizibilitetit teknik dhe qëndrueshmërinë tregtare të nxjerrjes së një burimi mineral.

Investimet në burimet minerale janë shpalosur në shënimin 4, Prona, impiantet dhe pajisjet.

2.11 INSTRUMENTET FINANCIARE

Njohja dhe çregjistrimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare nijhen kur Kompania bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit finanziar.

Pasuritë financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare, ose atëherë kur bëhet transferimi i pasurive financiare dhe të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve thelbësore. Një detyrim financiar çregjistrohet atëherë kur ai shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Përveç të arkëtueshmeve tregtare të cilat nuk përbajnë në vete përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmim të transaksionit në pajtueshmëri me SNRF 15, të gjitha pasuritë e tjera financiare fillimisht maten me vlerë të drejtë, të korriguar për kostot e transaksionit (aty ku është e zbatueshme). Pasuritë financiare, më përjashtim të pasurive financiare të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kosto të amortizuara.
